

# PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

SKEMA E FAZAVE TË PROÇESIT INDUSTRIAL TË GRUMBULLIMIT DHE RECIKLIMIT



**Emri I Subjektit: “ÇEKREZI METAL” sh.p.k**

**Administratori: Jani ÇEKREZI**

**Nipt: K91602003E**

**Vendndodhja: Tirane Vaqarr, Vaqarr, Truall me Nr.Pasurie 291/1,  
Zona Kadastrale 3712, Vaqarr**

**Tabela përmbledhese e permbjedhjes joteknike**

<b>1. Profili I operatorit</b>	<b>3</b>
<b>1.1 Proçesi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis</b>	<b>3</b>
<b>1.2 Kerkesat per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis te nje projekti</b>	<b>3</b>
<b>2. Përshkrimi i Instalimit;</b>	<b>5</b>
<b>2.1 Qellimi;</b>	<b>5</b>
<b>2.2 Subjekti investitor;</b>	<b>5</b>
<b>2.3 Vendodhja e ushtrimit te aktivitetit;</b>	<b>5</b>
<b>2.4 Te dhena teknike te aktivitetit;</b>	<b>5</b>
<b>3. Identifikimi dhe vleresimi I shkarkimeve kryesore ne mjedis;</b>	<b>8</b>
<b>4. Identifikimi dhe vleresimi I ndikimeve ne mjedis te aktivitetit;</b>	<b>9</b>
<b>4.1 Analizimi I ndikimeve te pritshme ne mjedis;</b>	<b>10</b>

## 1. Profili I operatorit

Subjekti “Çekrezi Metal” sh.p.k është i regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, NIPT K91602003E, me perfaqesues ligjor Jani CEKREZI. Operatori ushtron aktivitetin ne vendndodhjen Tirane Vaqarr, Vaqarr, Truall me Nr.Pasurie 291/1, Zona Kadastrale 3712, Vaqarr, me aktivitet “Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart”. Meqenese operatori zoteron Leje Mjedisit tipi B Nr I identifikimit te Lejes 3234, Nr 8679 Prot, date 29.12.2020, nepermjet shkreses Nr. 944/1 Prot date 04.03.2021 ne reference te VKM 419, date 25.06.2014 “Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisit te tipave A, B per transferimin e lejeve nga nje subjekt tek tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKB-JA” te ndryshuar do te kryeje ndryshim te kushteve te lejes se mjedisit duke shtuar dy kode ne lejen ekzistuese:

**ID 5.5 Magazinim i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme**

**ID 5.8 Magazinimi, rikuperimi I hekurishteve/skrapeve te metalit ose cmontimi I mbetjeve nga motoret e makinave**

Subjekti do te kryeje menaxhimin e mbetjeve, përmes nxitjes për zhvillim në nivel kombëtar të një biznesi social të qëndrueshëm, të balancuar dhe te standartizuar. Për arritjen e qëllimit, subjekti ndjek parametrat e tij sociale dhe mjedisore, përmes mbështetjes për/dhe nxitjes së grumbullimit të mbetjeve, si dhe krijon mundësi për një menaxhim të qëndrueshëm për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve.

Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) eshte nje prej instrumentave parandalues dhe minimizues te ndikimit mjedisor dhe per projektin specifik, hartohet duke u bazuar ne kerkesat e zhvillimit te aktivitetit nga subjekti “**Çekrezi Metal**” SH.P.K

Ky raport perfshin vleresimin, identifikimin, si dhe percaktimin e masave zbutese te ndikimit ne mjedis te aktivitetit te impiantit te prodhimit te betonit.

### 1.1 Procesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e zhvillimit te aktivitetit. Në procesin studimor të VNM përdoret informacioni dhe të dhënat teknike ekzistuese. Vleresimi i ndikimit ne mjedis hartohet qe ne fazen e projektidese per zhvillimin e aktivitetit, por gjithsesi edhe per aktivite ekzistuese te cilat jane objekt i nje leje mjedisore ose i ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis. Sipas kushtetutes se Republikes se Shqiperise, shteti siguron me te gjitha mjetet dhe mundesite qe ka, nje mjedis te paster dhe te sigurte per qytetaret dhe brezat e ardhshem.

### 1.2 Kërkesat Vlerësimit të Ndikimit në mjedis të një projekti

Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit.

Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përgatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë, dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj. Vlerësimi përfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente.

Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, të ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit.

Procedura e vlerëimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerëimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerëimit të ndikimit në mjedis.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerëimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

- a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II;
- b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I.

## 2. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

### 2.1 Qellimi i aktivitetit

Qellimi i këtij aktiviteti është të ushtroje veprimtarinë sipas përshkrimit: **Magazininim i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme dhe Magazininim, rikuperim i hekurishteve/skrapeve të metalit ose cmontim i mbetjeve nga motoret e makinave.** Ky subjekt ka si qëllim të sigurojë vlerësimin e përgjithshëm, të integruar dhe në kohë të ndikimeve mjedisore, të projekteve ose veprimtarive që kërkojnë të zbatohen, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis si dhe të ushtroje veprimtarinë e tij në përputhje me të gjitha parametrat mjedisore për mos të shkaktuar asnjë ndotje ose demtim të mjedisit.

### 2.2 Subjekti investitor

Operatori “ÇEKREZI METAL” sh.p.k. do të kryej operimin në vendndodhjen që posedon Lejen ekzistuese **Tirane Vaqarr, Vaqarr, Truall me Nr.Pasurie 291/1, Zona Kadastrale 3712, Vaqarr**

### 2.3 Vendodhja e aktivitetit

Zona e cila perdoret për funksionimin e aktivitetit është e rehabilituar, e shtruar me beton duke ulur njëkohësisht. Aktiviteti operon prej 25 vjetësh, pa krijuar shqetësime për banoret, njesitë e biznesit të ndodhur aty pranë. Territori është i rrethuar me mur tulle dhe i pajisur me porte hyrëse duke mos prishur kështu pamjen vizuale të zonës. Trualli në të cilin ndodhet objekti shtrihet në një terren të rrafshët dhe prona është e karakterizuar nga një sipërfaqe uniforme, ku efekti i erozionit nuk është i ndjeshëm. Përmirësimi urban i zonës, ka patur zhvillime mjaft të shpejta duke tërhequr interesin e zhvillimeve të reja të biznesit, gjithashtu edhe të zhvillimit të metejshëm të njesive urbane.

### 2.4 Të dhëna teknike të aktivitetit

#### **ID: 5.5 Magazininim i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme**

Për sa i përket mënyrës së funksionimit të aktivitetit është një praktikë shumë e thjeshtë e cila ndihmon në menaxhimin e integruar të mbetjeve. Regjimi i punës në aktivitetin në fjalë kryhet vetëm me një 1 turn e cila konsiston në disa hapa fare të thjeshtë. Hapat e punës nga hyrja e ngarkesës deri në dalje janë si më poshtë:

1. Mberritja e ngarkesës në vendndodhje
2. Shoqërimi i ngarkesës nga personi përgjegjës drejt peshorës
3. Kontrolli vizual i ngarkesës nga personi përgjegjës për natyrën e metaleve
4. Peshimi i ngarkesës
5. Depozitimi i ngarkesës në sheshin para seleksionimit
6. Diferencimi dhe depozitimi në sheshin pas seleksionimit
7. Shitja në tregun vendas apo të huaj

Pasi ngarkesa vjen ne ambjentin e aktivitetit, shoqerohet nga personi pergjegjes drej peshores. Perpara peshimit personi i cili shoqeron ngarkesen kryen inspektimin vizual per te pare nese eshte kategoria e mbetjeve qe pranohen ne aktivitet apo jo. Pas kesaj faze ngarkesa shkon drejt peshores e cila kryhen peshimin e saj. Personi pergjegjes ne regjistrin mbane rekorde per sasine llojin, dokument i nenshkruar nga dorezuesi dhe marresi. Pas kesaj faze mbetjet e metalit depozitohen ne sheshin e depozitimit para seleksionimit. Mbasi kryhet seleksionimi i tyre ato depozitohen ne vendin e percaktuar pas seleksionimit. Sheshi para dhe pas seleksionimit jane ne nje distance shume te afert me qellim levizjen ne menyre mekanike te tyre dhe minimizimin e cdo impakti negativ ne mjedis. Pas kalimit te te gjitha hallkave matalet e diferencuar shiten ne kompani riciklimi brenda dhe jashte vendit, te cilat dergohen/terhiqen duke respektuar legjislacionin aktual mbi transportimin e mbetjeve.

**Venddepozitimi I skrapeve te paseleksionuar**, do te sherbeje per shkarkimin e ngarkeses. Pas mbarimit te etapave te pranimit dhe peshimit ato do te depozitohen ne kete vend per tu diferencuar dhe per tu depozituar ne vendin e percaktuar pas seleksionimit.

**Venddepozitimi i mbetjeve te skrapit pas seleksionimit.** Ne kete siperfaqe depozitohen mbetjet e skrapit pas seleksionimit te ndara sipas kategorise perkatese. Duke qene se subjekti eshte ekzistues prej disa vitesh, klientet me te cilet operatori bashkepunon jane ne dijeni te tipologjise qe se skrapeve qe pranohet ne kete aktivitetit. Gjithesesi perpara peshimit operatori kryen nje inspektim vizual te skrapit, nese mund ta magazinoje apo jo.

#### **ID 5.8 Magazinim, rikuperim i hekurishteve/skrapeve te metalit ose cmontim i mbetjeve nga motoret e makinave.**

Demontimi i makinave, nenkupton heqjen e te gjitha pjeseve te paperdorshme qe ndodhen ne nje mjet motorik te tipit makine, furgon, apo motor. Demontimi i makinave kryhet duke zbatuar te gjitha standartet te cilat mund ti perfizojme si rregulla te perpiluara qe perfshijne te gjitha te arriturat me te reja te teknikes qe percaktojne cilesine e prodhimit, materialit, permbajtjen, permasat, formen, llojin, shenjat etj. Me ane te standarteve realizohet unifikimi, prodhimitaria me cilesore, lehtesohen kushtet e punes, kursimi i energjise, zvoglohen harxhimet per investime dhe cmimet e kushtimit.

Ambjente ne te cilin zhvillohet aktiviteti eshte kapanon, i mbuluar me panel sancuid metalik. Siperfaqe eshte e shtruar me shtrese gjeotekstili e holle, hidrolizues argjilor dhe beton arme 300. Ky lloj shtrimi eshte ne te gjitha siperfaqen e subjektit duke perjashtuar cdo lloj kontaminimi te tokes.

#### **Proceset e punes**

Pasi makat vijne ne ambjentet e instalimit ato fillimisht likuidohen. Ndryshe nga procesi i magazinimit te hekurishteve/skrapeve qe nuk permbajne materiale te rrezikshme, mjete per demontim nuk peshohet, por vleresohet nga teknikes perkatese.

Pas kalimit te kesaj faze, automjetet vendosen ne nje ure e cila do te sherbeje edhe per cmontimin e pjeseve te tyre. Pajisjet qe do te perdoren per cmontimin:

1. Trapano dore, do te beje te mundur zberthimin e nyjeve lidhese te konstruksionit metalik.
2. Kacavida, celsa, pjese te cilat do te ndihmojne ne zberthimin e plote edhe te pjeseve te

cilat nuk kane nevojë te zberthehen me trapano.

3. Trako dore, do te sherbeje per prerjen e pjeseve qe cilat nuk jane te vidhosura ne nyje.

Pas cmontimit te pjeseve, proces ky i cili ndodh duke mbatjur parasysh kushtet eksploative, kushtet teknologjike dhe kushtet ekonomike, do te depozitohen ne vendin e percaktuar per skape. Pjeset e tjera te tipi goma bateri, do te vendosen ne nje zone te percaktuar te ambjentit per tu terhequr nga operatore te licencuar, per te cilat operatori posedon kontrata bashkepunimi. Vajrat do te vendosen ne depozita metalike, hermetike dhe te padepertueshme te cilat gjithashtu do te terhiqen nga operatore te licencuar, me qellim trajtimin/asgjesimin e metejshem te tyre.


Siperfaqe ne te cilen do te zhvillohet ky aktivitet permbush te gjithe kondicionet urbane dhe qekur eshte menduar si funksionale per aktivitetet ne fjale, jane marre ne konsiderate shume faktore per permiresimin e operimit. Siperfaqe eshte i ndertuar me disa shtresa te cilat nuk demtojne formacionin tokesor. Shtresa e pare mbi dheun e tokes eshte e hidroizoluar me material argjilor i cili nuk prish cilesine e formacionit gjeologjik te toke. Pas shtreses se hidroizoluar eshte hedhur beton arme i cili nga kalkulimet inxhinierike ne perputhje me kapacitetin maksimal te skrapit te depozituar eshte rezistent. Marka e betonit eshte perdorur 300 arme. Poshte shtreses hidroizoluar eshte vendosur nje shtrese shume e holle gjeotekstili me qellim qe te parandaloje cdo lloj kontaminimi me token.

Shtresa e pare e emertuar me numrin 1 eshte formacioni i tokes ne te cilin zhvillohet veprimtaria. Shtresa e dyte e emertuar me numrin 2 eshte shtresa e holle gjeotekstili e cila vendoset ne funksionin e nje filtruesi per te shmangur cdo lloj kontaminimi te tokes. Shtresa 3 korespondente e numrit 3 ne figure eshte shtresa hidrolizuese, shtrese argjilore per te mos lejuar kalimin e ujrave ne formacionet e poshtme. Shtresa 4 dhe perfundimtare eshte shtresa e betonit e markes 300 e cila eshte studiuar ne perputhje me kapacitetin magazinues te skrapit. Shtresa e betonit eshte rezistence dhe me nje konsistence te larte me qellim moslejimin e kontaminimit te tokes. Perpos ketij fakti jane vendosur edhe shtresat e tjera, rrjedhimit nuk kemi asnje mundesi per kontaminim.

Siperfaqe eshte e ndertuar ne nje menyre te tille me pjerresine e duhur me qellim qe ujrat e shiut te drejtohen drejt kunetava e me pas drejt impiantit qe operatori perdor per trajtimin e ujrave.

**Impianti i trajtimit te ujrave** eshte modern i standartizuar dhe ne perputhje me kapacitetin e projektuar. Impianti i trajtimit eshte si ndare ne dy sektore:

1. Sektori i Sedimentit (ose i ndarjes se papastertise), i bere ne nje ndarje te kombinuar me ndarjen e heqjes se vajit
2. Sektori Gravimetrik i naftes me filtrimin e shkrires



*Legjenda*

- 1 – Rezervuari i sedimentit
- 2 - Rezervuari i ndarjes se vajit
- 3 - Port hyrje me mbyllje automatike dhe galexhant
- 4 - Sonde per matjen e nivelit te vajit
- 5 – Pompe per shkarkim te vajit te akomuluar
- 6 – Filtri

**INFRASTRUKTURA E BRENDSHME**

Operatori “CEKREZI METAL” sh.p.k, ka nje insfrastruktura te mireorganizuar gje e cila verehet edhe ne planimetrite e vendosura. Rruget levizese brenda aktivitetit jane te lira me qellim levizjen e lire te automjeteve por edhe te zjarrfikeseve apo ambulancave ne rastet emergjente. Levizja e ngarkeses kryhet vetem ne nje sens. Argjinatura rrethuese eshte e perbere nga nje mur i shoqeruar ne te gjithë perimetrin me kangjella dhe tekstil te trrashe, me bimesi autoktotone shtatlarte, komponente keto, qe pengojne pamjen vizuale brenda vendit te operimit. Ky lloj ndertimi i argjinaures kryhet per dy aresye. Se pari per uljen e impaktit negativ ne mjedis dhe se dyte per mosprishjen e peisazhit vizual se zones ne fjale.

Aktiviteti qe ushtron shoqeria “CEKREZI METAL” sh.p.k, si lende te pare ne funksionimin e instalimit do te jene **materiale skrapu te perziera (hekur, bakerr, alumin, celik, giz, etj), gjithashtu dhe automjete te cilat do te vijne per demontim ne ambientet e instalimit.**



**Lendet e para: ID 5.5 Magazinim i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme**

Metale (përfshi dhe aliazhet e metaleve) - 17 04

Bakër, bronx, tunxh - 17 04 01

Alumin - 17 04 02

Alumb - 17 04 03

Zink – 17 04 04

Hekur dhe çelik – 17 04 05

Kallaj – 17 04 07

Metale te perziera – 17 04 07

Metale ferore – 16 01 17

Metalet – 20 01 40

**Lendet e para: ID 5.8 Magazinimi, rikuperimi I hekurishteve/skrapeve te metalit ose cmontimi I mbetjeve nga motoret e makinave**

Mjete jashtë përdorimit që nuk përmbajnë lëngje apo komponente të tjera të rrezikshme – 16 01 06

**Energjia, uji, do te jene lende ndihmese te aktivitetit-** Furnizimi me energji elektrike do te sigurohet nga rrjeti i shperndarjes se zones ku ndodhet dhe aktiviteti i “Çekrezi Metal” sh.p.k energjia elektrike do te perdoret vetem per ndricimin e ambjenteve, ndersa uje do te sigurohet nga rrjeti i furnizimit te zones dhe do te perdoret vetem per nevoja sanitare.

**3. Identifikimi dhe Vleresimit I shkarkimeve ne mjedis**

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem.

Nga zhvillimi I aktivitetit pritet qe te kete shkarkime minimale ne mjedis, duke iu referuar edhe natyres se tij. Disa nga shkarkimet e mundshme te ketij aktiviteti jane si me poshte vijon:

1. **Shkarkime ne ajer-** Mjetet te cilat kryejne transportin e matalit kane clirime te gazeve te djegies se karburantit (CH<sub>4</sub>, SO<sub>2</sub>, CO, CO<sub>2</sub> dhe pluhur ne nivele te uleta). Per minimizimin e tyre mjetet do te jene te kualiduara dhe do ti nenshtrihen kontrolleve periodike ne servise.
2. **Shkarkime ne uje-** Shkarkime ne uje do te kemi vetem nga sherbimet higjeno sanitare, te cilat jane pa karakter ndotes dhe nuk prishin cilesine e mjedisit uJOR prites, urjat e aktivitetit do kalojne ne impiant trajtimi te ujrave.
3. **Shkarkimet ne toke-** Nga zhvillimi I ketij aktiviteti nuk do te kemi shkarkime ne toke. Mbetjet nga ky aktivitet do te evadohen ne menyren me te mire te mundshme. Mbetjet nga linja teknologjike nuk do te kemi, ndersa mbetjet e aktivitetit te punonjesve do te

depozitohen ne kosha me ngjyra e me pas do te depozitohen ne vendin e perbashket te percaktuar nga Njesia e Qeverisjes Vendore.

#### **4. Identifikimi dhe vleresimi i ndikimeve ne mjedis te aktivitetit**

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi “Ndotësi paguan”
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe VKM Nr. 13, date 04.01.2013 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis” dhe ka si synim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;

#### 4.1 Ndikimet e pritshme te mundshme ne mjedis nga zhvillimi I aktivitetit

Ndikimet e mundshme gjate fazes se funksionimit te aktivitetit mund te permbliidhen sipas elementeve te mjedisit, si me poshte:

<b>Ndikimet negative ne mjedis</b>
<b>Rrezatimi Jonizues</b>
Nga zhvillimi i aktivitetit nuk kemi rrezatime jonizuese.
<b>Vibracionet</b>
Funksionimi i aktivitetit gjeneron vibracione shume te lehta te cilat nuk jane shqetesuese per floren dhe faunen, zonat urbane dhe bizneset ne afersi te aktivitetit. Keto vibracione do te gjenerohen vetem ne harqe kohore te caktuara gjate levizjeve te mjeteve te renda.
<b>Ndikimet ne popullsi</b>
Zhvillimi I aktivitetit nuk do te kete ndikime ne levizjen apo zhvendosjen e popullise se rajonit, por mund ta quajme nje impact pozitiv pasi do te punesohen individe te zone. Zonat e banuara kane nje distance relativisht te konsiderueshme duke qene keshtu te mbrojtur nga ata pak ndikime nevatie qe mund te shfaqet aktiviteti.
<b>Ndikimet ne toke</b>
Ne kete aktivitet nuk mund te kemi ndikime ne toke per aq kohe sa operatori ploteson te gjithet standartin per zhvillimin e aktivitetit. Aktivitete te tilla ndihmojne ne miremanxhimin e mbetjeve dhe jane shume te rendesishme duke u shoqeruar me nje impact pozitiv si nderlidhes te kompanive ricikluese.
<b>Mbetjet e ngurta</b>
Mbetjet e ngurta qe dalin si rezultat i aktivitetit te punonjesve do te grumbullohen ne vendet e caktuara nga shoqeria dhe me pas do te dergohen per ne vendet e caktuara nga pushteti vendor. Do te punohet qe keto mbetje te ndahen qe ne burim dhe do te perdoren kontiniere hermetike qe te evitohen aromat e pakendeshme qe mund te vijne si pasoje e kushteve klimaterike.
<b>Ndikimet ne ajer</b>
Aktivitete te tilla nuk shoqerohen me ndikime ne ajer. Ndikime te vetme te cilat do te quhen ndikime ne ajer jane nga levizja e mjeteve brenda aktivitetit. Keto ndikime jane mese normale dhe teresisht te menaxhueshme. Mjetet do te qendrojne per nje kohe shume te shkurter ne vendndodhje, por perpos kesaj ato do te iken gjate priudhes se shkarkimit te skrapit. Ndikime te tjera ne ajer nuk kemi.
<b>Ndikimet ne ujera</b>

Operatori ka te instaluar nje impiant te trajtimit te ujrave menyre qe te evadoje dhe te ruaj sa me shume mjedist ujore pritese. Zona e ne te cilen zhvillohet aktiviteti eshte nje zone e cila ka te gjithe strukturen e nevojshme te operimit. Siperfaqe eshte e shtruar me beton + hidroizues argjilor dhe shtrese gjotekstili, rrjedhimisht nuk mund te kemi ndikime ne ujra. Ne perimetrin e siperfaqes me ane te kunetave te kullimit uji kalon ne impiant i cili trajtohet dhe me pas kalon ne mjedisin ujrave prites. Shkarkimet ne kanalizime do te kemi vetem nga sherbimet higjeno sanitare te cilat nuk kane ndikim ne ujra.

#### **Ndikimet ne klime**

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

#### **Ndikimet ne floren dhe faunen**

Zona ne te cilen ushtrohet aktiviteti eshte nje zone ne te cilen nuk takohen elemente te spikatur te flores. Perreth kesaj zone, mund te hasim bimesi te ulet dhe barishte te ndryshme. Aspekti faunistik i lidhur ngushte me mjedisin rrethues ketu paraqet nje larmi biologjike te varfer. Zhvillimi i ketij aktiviteti nuk paraqet asnje ndikim negativ ne flore apo faun.

#### **Ndikimet nga zhurmat**

Aktiviteti qe zhvillon shoqeria "CEKREZI METAL" sh.p.k, eshte nje aktivitet I cili mund te shoqerohet me gjenerime te lehta zhurme port e cilat jane te monitorueshme dhe te menazhueshme. Zhurma do te kemi gjate procesit te punes sidomos ne Kohen kur do te shkarkohen ngarkesat por eshte nje gjenerim momental dhe zgjat vetem suda sekonda. Per sa I perket gjenerimeve nga burime te tjera do te jene ne vlera normale krahasuar me aktivite te po te njejtës natyre. Largesia nga zonat e banuara jane te konsiderueshme dhe nuk pritet te kete ndikim te drejtperdrejte ne to.

#### **Ndikimet e aktivitetit te zhvillimit ne rruget lokale dhe transportin**

Gjate zbatimit te aktivitetit nuk do kete ndryshime te rrjetit te rrugëve lokale dhe transportit. Gjithashtu nuk eshte e nevojshme devijimi apo hapja e ndonje rrjeti te ri infrastrukturor.

#### **Ndikimet e aktivitetit te zhvillimit mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike historike dhe zonat e mbrojtura**

Aktiviteti qe ushtron shoqeria zbatohet ne nje zone ne sipërfaqen e se ciles dhe ne nëntokën e saj nuk ka ndertime lidhur me trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra te tjera njerezore. Kjo tregon qe zona eshte zone e lire jo vetem per te realizuar kete aktivitet, por njekohesisht nje zone ne te cilen aktiviteti nuk shoqerohet me pasoja ndotese per mjedisin.

#### **Ndikime ne rrjetin hidrografik**

Aktiviteti qe zhvillon subjekti nuk ka ndikime ne rjetin hidrografik. Zona ne te ccilen zhvillohet nuk takon elemente te spikatur hidror si pershembull lumenj etj.

**Ndikimi social-ekonomik**

Me operimin e ketij aktiviteti pritet te kete nje impakt pozitiv ne ekonomine e vendit. Operatori do te punesoje personel te zones, duke bere te mundur rritjen ne nivelin ekonomik dhe te punesimit.

“ÇEKREZI METAL” sh.p.k.  
Administratori

Jani ÇEKREZI

